



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Bordi i Administrimit

Nr. 1944 Prot

Shkodër, më 17.06.2021

V E N D I M

Nr. 199 datë 17.06. 2021

**"MBI MIRATIMIN E PAGESËS SË TARIFËS PËR SHËRBIMET E RASH PËR VITIN 2020"**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 49, Aktmarrëveshja "Për krijimin e qendrës ndërinstitucionale të rrjetit akademik shqiptar", VKM nr.88 datë 14.02.2018 " Për krijimin e qendrës ndërinstitucionale të rrjetit akademik shqiptar (RASH), Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 17.06.2021

**Vëren,** Bordi Drejtues i RASH me Vendimin nr. 49, datë 03.07.2020, "Për nivelin e tarifës së shërbimeve", ka miratuar në tejkalim të kompetencës tarifë shërbimi. Nga Administratori, pretendohet se ky vendim i Bordit Drejtues të RASH bie ndesh me Aktmarrëveshjen "Për krijimin e qendrës ndërinstitucionale të rrjetit akademik shqiptar", neni 8, pika 2, germa d parashikon që: Asambleja e Anëtarësisë " miraton tarifën e përdorimit të shërbimeve të përbashkëta dhe kontributin vjetor të anëtarësisë" e po kjo Akt-marrëveshje, në nenin 10, pika 1 germa "h" i njej Bordit drejtues të RASH vetëm kompetencën e "propozimit të tarifave përkatëse të përdorimit të shërbimit dhe kontributin vjetor të anëtarësisë" e pranuar nga kthim përgjigjja e qendres ndërinstitucionale të rrjetit akademik shqiptar nr.21-104/2 datë 14.05.2021. Ndërkohë në mënyrë të njëanshme nga RASH është ndërprerë shërbimi i internetit me datë 01.06.2021 duke ndërprerë procesin normal të punës në institucion. Në këtë situatë të cënimit të marrëveshjes nga ana e RASH dhe shpërblimit të shërbimit të internetit për shkak të mospranimit të pagesës së tarifës së miratuar në tejkalim kompetence deri në zgjidhjen e konfliktit në rrugë gjyqësore, për efekt të mos ndërprerjes së këtij shërbimi të domosdoshshëm, sidomos në këtë periudhë kur procesi mësimor dhe provimet po zhvillohen kryesisht online për shkak të pandemisë Covid 19

**Vendosi**

1. Zgjidhjen e mosmarrëveshjes së tarifave në rrugë gjyqësore ku të kërkohet edhe shpërblimi i dëmit shkaktuar institucionit tonë.
2. Realizimin e pagesës së tarifës për shërbimet e RASH për vitin 2020, sipas tarifimit dhe faturimit nga ky ofertues, deri në zgjidhjen gjyqësore të konfliktit.
3. Ngarkohet drejtorja juridike për të përgatitur padinë dhe siguruar përfaqësimin.
4. Ngarkohet administratori dhe drejtorja ekonomike për realizimin e pagesës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BORDIT**

**NAMIK KOPLIKU**

